



Raport mbi veprimtarinë vjetore të investimit të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme gjatë vitit 2025.

Referuar ligjit nr. 133, datë 22.12.2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 18, pika 1, të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë Nr.56, datë 03.10.2017 “Për miratimin e rregullores “Për fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe procedurat për administrimin e tij””, të ndryshuar dhe vendimit Nr. 1734, datë 27.03.2020 të Zëvendësguvernatorit të dytë të Bankës së Shqipërisë, për miratimin e “Politikës së administrimit të mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme”, i ndryshuar, paraqitet si vijon veprimtaria vjetore investuese për mjetet financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për periudhën Janar - Dhjetor 2025 dhe gjendja e tij në fund të vitit 2025.

Në fund të muajit dhjetor të vitit 2024, Komiteti i Investimeve në zbatim të Politikës së Administrimit të Mjeteve Financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, miratoi strategjinë vjetore të investimit të mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për vitin 2025.

Politika e investimit të mjeteve financiare të FNJ, vijon të ndjekë parimet e likuiditetit të lartë, rrezikut të ulët të kredisë dhe normës së lartë kthimit pas respektimit të dy parimeve të para.

Në zbatim të njoftimit të Bankës së Shqipërisë për kontributin e vitit të tetë, të gjitha bankat bënë pagesën përkatëse të kontributit për këtë vit, në shumën prej 1 041 020 620 lekë, brenda afatit të pagesës, datë 30 prill 2025.

Mjetet financiare në dispozicion të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në fund të vitit 2025, arrijnë vlerën prej 7 024 milionë lekë, duke shënuar një rritje prej rreth 22% krahasuar me një vit më parë.


Arkëtimi i kontributit të vitit të tetë u krye gjatë muajit Prill (02.04 – 30.04.2025). Me qëllim mbajtjen e një portofoli investimesh të diversifikuar, Agjencia e ka shtrirë





investimin e mjeteve të fondit gjatë gjithë vitit. Gjatë vitit 2025, Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme është investuar kryesisht në instrumente me maturitete afatgjata.

Portofoli në valutë përbëhet vetëm nga monedha euro dhe në fund të vitit 2025, arriti vlerën prej 4.07 milion euro, që përbën rreth 5.69% të totalit, duke respektuar kufirin e vendosur në politikën e administrimit të mjeteve financiare të FNJ. Në mungesë të emetimeve në euro në tregun e brendshëm të titujve të Qeverisë Shqiptare, kjo shumë, në pjesën më të madhe të vitit, është investuar në depozita me afat pranë Bankës së Shqipërisë.



Për fundin e vitit 2025, nënportofoli në lekë është në vlerën 6.53 miliard lekë dhe ka një peshë prej 94.31% kundrejt të gjithë vlerës së Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme. Investimet në monedhën vendase, janë bërë duke pasur parasysh shpërndarjen sipas maturiteteve në një larmi datash maturimi me qëllim evitimin e përqendrimeve të larta në data të caktuara.


Gjatë vitit 2025 është investuar në tituj me disa maturitete, përkatësisht në muajin Shkurt është investuar në obligacion me afat maturimi 2 vjeçar, në Prill është investuar në obligacion 10 vjeçar, në muajt Maj, Gusht dhe Tetor është investuar në obligacione me maturitet 2 vjeçar, ndërsa në Nëntor është investuar në obligacion 7 vjeçar.

Të gjitha investimet e këtij fondi në nënportofolin në lekë janë në tituj të Qeverisë Shqiptare dhe janë kryer në tregun primar.






Në grafikët në vijim paraqitet ndarja e mjeteve financiare të Fondit në fund të vitit 2025 sipas instrumenteve.



Përgjatë të gjithë vitit, Agjencia është kujdesur jo vetëm për një administrim sa më efektiv të fondit, por edhe duke mbajtur në vëmendje ruajtjen e raporteve sipas transheve dhe monedhës, të përcaktuara në politikën e investimit dhe strategjinë e investimit. Për vitin 2025, ka pasur një rritje e maturiteteve të investimeve në obligacione të emetuara nga Qeveria Shqiptare. Në këtë vit nuk ka pasur emetime të titujve në euro në tregun e brendshëm dhe për rrjedhojë portofoli në euro për pjesën më të madhe të vitit është mbajtur si depozitë duke ruajtur njëkohësisht limitin e transhit të likuiditetit.

Transhi i likuiditetit në fund të vitit ishte në vlerën 896.5 milion lekë dhe është rritur me 30.4 % krahasuar me fundin e një viti më parë. Në fund të vitit transhi i likuiditetit përbëhet nga shuma e mbajtur në depozitë në lekë dhe në euro në Bankën e Shqipërisë, si dhe nga titujt me maturitet të mbetur të shkurtër.





Transhi i investimit në fund të vitit ka vlerën 6.03 miliard lekë dhe ka pësuar një rritje prej 21.1% krahasuar me një vit më parë. Kjo rritje ka ardhur në pjesën më të madhe si rezultat i investimeve në tituj me maturitet afatgjatë.

Performanca e arritur nga administrimi i këtij fondi është e kënaqshme, ku norma vjetore e kthimit për portofolin e investuar të FNJ në mbyllje të vitit financiar 2025 është 3.69¹%.

¹ Llogaritur si raport i të ardhurave nga interesat gjatë 2025 me aktivet neto në dispozicion të ANJ në fund të 2025, sipas pasqyrave të audituara të FNJ për vitin 2025.

